



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.85

12 korrik

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.424, datë 2.6.2010	Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë	4425
Vendim i KM nr.426, datë 9.6.2010	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të ndërtimit dhe shfrytëzimit të portit të jahteve në kalanë e Turrës, komuna Synej, Kavajë, dhe miratimin e bonusit në procedurën për zgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë “Finsec ltd”	4433
Vendim i KM nr.427, datë 9.6.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen – Kalimash	4434
Vendim i KM nr.429, datë 9.6.2010	Për shpalljen e zonës arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Shkodrës dhe miratimin e rregullores së administrimit	4440
Vendim i KM nr.430, datë 14.6.2010	Për miratimin në parim të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “Microsoft Corporation”, për projektin e partneritetit strategjik, në fushën e teknologjisë së informacionit	4445
Vendim i KM nr.432, datë 28.4.2010	Për zgjerimin e kufijve të rezervatit natyror të menaxhuar Kune-Vain-Tale	4446
Vendim i KM nr.433, datë 5.5.2010	Për krijimin, përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe kompetencat e bordit drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit	4450
Vendim i KM nr.434, datë 26.5.2010	Për kalimin në përdorim, pa shpërblim, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për Fakultetin e Shkencave Sociale, të objektit nr.35, në komandën e doktrinës dhe stërvitjes	4452

Vendim i KM nr.435, datë 2.6.2010	Për administrimin e të ardhurave që krijohen nga shitja e dokumentacionit tatimor, pullave fiskale dhe biletave të transportit rrugor	4452
Vendim i KM nr.436, datë 2.6.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.1634, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe të mënyrës së mbështetjes financiare, për ruajtjen e rezervës gjenetike të racës autoktone të buajve”	4453
Vendim i KM nr.437, datë 9.6.2010	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 8.12.2009, për çështjen nr.44023/01 “Caka kundër Shqipërisë”	4453
Vendim i KM nr.438, datë 9.6.2010	Për disa shtesa në vendimin nr.467, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për kualifikimin, shkencor e pedagogjik, të personelit akademik”, të ndryshuar	4454
Vendim i KM nr.439, datë 9.6.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.1070, datë 21.10.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kuotave të pranimit dhe të tarifave të shkollimit në programet e studimeve “master i nivelit të dytë”, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2009–2010, dhe për një ndryshim në vendimin nr.829, datë 29.7.2009 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimeve “Master i nivelit të dytë”, në Fakultetin e Muzikës, të Akademisë së Arteve, dhe miratimin e kuotave dhe të tarifave për këto programe””, të ndryshuar	4455
Vendim i KM nr.440, datë 9.6.2010	Për hapjen e programeve të reja të studimit, pranë kolegjit profesional privat “New Generation” (Brezi i ri), Tiranë	4455
Vendim i KM nr.441, datë 9.6.2010	Për një shtesë në vendimin nr.730, datë 6.11.2003 të Këshillit të Ministrave “Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Punës dhe për caktimin e përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave në këtë këshill”, të ndryshuar	4456
Vendim i KM nr.442, datë 16.6.2010	Për disa shtesa në vendimin nr.718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar	4456
Vendim i KM nr.444, datë 9.6.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.289, datë 28.4.2010 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen “Park kombëtar” të ekosistemit natyror detar pranë gadishullit të Karaburunit dhe ishullit të Sazanit”	4459

VENDIM
Nr.424, datë 2.6.2010

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR SISTEMIN E AKREDITIMIT, ORGANIZIMIN DHE VEPRIMTARINË E INSTITUCIONEVE TË SIGURIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, pikës 2 të nenit 60 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Përbërja, struktura, organika dhe funksionimi i Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) dhe të Këshillit të Akreditimit përshtaten brenda 2(dy) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
 3. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë të fillojë procedurat për kryerjen e vlerësimit të saj të parë të brendshëm, si pjesë e procesit të aplikimit për t’u bërë anëtare në Rrjetin Europian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, ENQA ose EQAR.
 4. Vendimi nr.303, datë 1.7.1999 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e sistemit të akreditimit në arsimin e lartë”, i ndryshuar, shfuqizohet.
 5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Akreditimit dhe Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë për zbatimin e kësaj rregulloreje.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR SISTEMIN E AKREDITIMIT, ORGANIZIMIN DHE VEPRIMTARINË E
INSTITUCIONEVE TË SIGURIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË

PJESA I
ORGANIZIMI, VEPRIMTARIA, TË DREJTAT DHE DETYRAT

Neni 1
Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore përcakton veprimtarinë e Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe të agjencive të tjera të vlerësimit të arsimit të lartë në fushën e sigurimit të jashtëm të cilësisë, të Këshillit të Akreditimit, si dhe organizimin e tyre në Republikën e Shqipërisë.
2. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në institucionet e arsimit të lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë dhe akreditimit.
3. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë në institucionet e arsimit të lartë kryhet prej Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL), ose/edhe nga agjenci të tjera të vlerësimit të arsimit të lartë, që janë anëtare të Rrjetit Europian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA dhe EQAR).
4. Kjo rregullore përcakton gjithashtu edhe marrëdhëniet e APAAL dhe agjencive të tjera në raport me Këshillin e Akreditimit (KA), Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, institucionet publike dhe private të arsimit të lartë dhe aktorë të tjerë që lidhen me fushën e arsimit të lartë.

Neni 2

Organizimi i Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë

1. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë është institucion me statusin e personit juridik publik, në varësi të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Struktura dhe organika e saj miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Numri i punonjësve të agjencisë është brenda numrit të punonjësve të miratuar për MASH. Buxheti i APAAL mbulohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

2. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë bashkëpunon me rrjetin e agjencive për sigurimin e cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë.

Neni 3

Detyrat dhe veprimtaritë e Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë

1. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) është përgjegjëse për promovimin dhe vlerësimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë publik dhe privat. Në veprimtaritë e saj, APAAL mbështetet në standardet shtetërore të cilësisë dhe në standardet dhe udhëzimet përkatëse të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe atë ndërkombëtare të arsimit të lartë.

2. Në kryerjen dhe ndjekjen e procesit të vlerësimit, APAAL gëzon autonomi në lidhje me procedurat e vlerësimit, përmbajtjen e raporteve e rezultateve të vlerësimit, zgjedhjen e metodave dhe instrumenteve të vlerësimit, krijimin dhe përbërjen e grupeve të ekspertëve të vlerësimit, si dhe në formulimin e raporteve dhe rezultateve të vlerësimit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. APAAL pranon dhe regjistron kërkesat e IAL-ve për vlerësim dhe akreditim. Ajo përgatit kalendarin vjetor të vlerësimeve dhe ia paraqet atë për miratim Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Ky kalendar bëhet publik për të gjitha IAL-të publike dhe private.

4. Agjencia organizon kryerjen e vlerësimeve në të gjithë parametrat teknikë dhe në përmbajtje të sistemit të arsimit të lartë, të veprimtarive institucionale të institucioneve të arsimit të lartë, të cilësisë së programeve të studimit, si dhe të veprimtarive të kërkimit dhe zhvillimit teknologjik.

5. Agjencia kryen vlerësimin paraprak të programeve të reja të studimit për institucionet private dhe publike të arsimit të lartë. Ky vlerësim kryhet me qëllim hapjen e programeve të reja të studimit/institucioneve dhe kryhet nga vlerësues ekspertë sipas fushave, nën drejtimin dhe përgjegjësinë e agjencisë.

6. Agjencia zhvillon veprimtari të vlerësimit të jashtëm të cilësisë, me qëllim akreditimin e programit/ve të studimit apo të institucionit (publik dhe privat) dhe bën publike raportet dhe rezultatet e vlerësimeve të kryera.

7. APAAL përcakton kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e ekspertëve të vlerësimit, apo konsulentëve, vendas a të huaj, të cilat i bën publike, pasi merr pëlqimin në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Përzgjedhja e tyre bëhet përmes një konkurrimi publik. Lista e ekspertëve përditësohet së paku çdo vit.

8. Në shërbim të politikave të arsimit të lartë, dhe me kërkesë të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, agjencia mund të kryejë vlerësime analitike dhe/ose krahasuese të institucioneve dhe të programeve e fushave të arsimit të lartë, sipas treguesve të caktuar dhe në raport me standardet ekzistuese, vendase apo ndërkombëtare. Mbështetur në këto vlerësime harton raporte analitike të sistemit të arsimit të lartë sipas një ose disa aspekteve e treguesve. Mbështetur në kritere të qarta, mbi të dhëna të sakta e të besueshme dhe në rezultatet e vlerësimit, APAAL, në bashkëpunim me KA, kryen dhe shpall renditjen (*ranking*) e IAL-ve ose diplomave të ngjashme në përputhje me këto rezultate. Shpeshësia e kryerjes së *ranking*-ut dhe kriteret e tij miratohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

9. Agjencia bashkëpunon me institucionet publike dhe private të arsimit të lartë për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke rekomanduar kriteret,

metodat dhe indikatorët e përgjithshëm, si dhe kriteret e metodat e përshtatshme për vetëvlerësimin periodik të sistemit. Ajo udhëzon dhe trajnon njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe mban marrëdhënie të vazhdueshme me këto njësi.

10. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë bashkëpunon me rrjetet e agjencive për sigurimin e cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe ato që operojnë në rang ndërkombëtar.

11. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë bashkëpunon me institucionet e arsimit të lartë në vend dhe institucione që lidhen me to, organizata profesionale, institucione që lidhen me tregun e punës, për shkëmbim informacioni dhe ekspertize duke i përfshirë aktivisht në procesin e vlerësimit të jashtëm.

12. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë bashkëpunon edhe me këshillat studentorë të IAL-ve dhe Këshillin Kombëtar të Studentëve, të ngritura siç parashikohet në ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duke i përfshirë këta aktorë në procesin e vlerësimit të jashtëm, si dhe për mbledhje informacioni e të dhënash që i shërbejnë vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë në AL në tërësi.

13. Në bashkëpunim me KA-në APAAL harton në fund të çdo viti një raport të veprimtarisë së saj, i cili i dërgohet Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe më pas bëhet publik brenda 4-mujorit të parë të vitit pasardhës.

14. APAAL jep, përmes faqes zyrtare të saj, informacion publik të përditësuar mbi statusin e IAL-/programeve lidhur me vlerësimin dhe akreditimin, si dhe bën të njohur, para fillimit të çdo viti akademik listën e programeve të studimit dhe institucioneve të arsimit të lartë të akredituar.

15. APAAL lëshon certifikatën përfundimtare të akreditimit pas marrjes së vendimit të akreditimit nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Modeli i kësaj certifikate miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Neni 4

Detyrat e drejtorit dhe punonjësve të Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë

1. Drejtori i Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë është autoriteti drejtues i saj.

2. Drejtori emërohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, mbi bazën e konkursit, i cili zhvillohet në përputhje me procedurat e ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”. Ai ka së paku gradën shkencore “Master i shkencave” në fushën e edukimit ose “Doktor”, mbi tre vjet përvojë pune si mësimdhënës në IAL, si dhe eksperiencë të fituar në shkollat perëndimore.

3. Drejtori i Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë është përgjegjës për organizimin e brendshëm të agjencisë, si dhe të veprimtarive të saj, dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera që bashkëpunojnë në procesin e vlerësimit.

4. Drejtori i Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë drejton përgatitjen e të gjitha dokumenteve që në bazë të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe të kësaj rregulloreje, janë detyrë e Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë.

5. Drejtori përcakton përbërjen e grupit të ekspertëve të vlerësimit, në mënyrë transparente, për çdo vlerësim të jashtëm dhe ia përcjell për miratim Këshillit të Akreditimit.

6. Paga e drejtorit dhe e punonjësve të APAAL është në përputhje me nivelin dhe kategorinë përkatëse të institucioneve të varësisë nga ministritë e linjës.

Neni 5

Veprimtaritë e agjencive të tjera të vlerësimit

1. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë mund të kryhet edhe nga agjenci të tjera vlerësimi, që janë anëtare me të drejta të plota të Rrjetit European për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) ose të Regjistratit European të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë (EQAR). Vlerësimi i jashtëm nga këto agjenci kryhet me qëllim akreditimin, *rating*-un ose *renking*-un e programit/ve të studimit apo të institucionit të arsimit të lartë. Vlerësimi i jashtëm nga këto agjenci kryhet në përputhje edhe me standardet e procedurat e miratuara nga MASH-i.

2. Vlerësimi i jashtëm mund të kryhet edhe në bashkëpunim midis një agjencie të huaj, pjesë e ENQA-s e EQAR-it, dhe Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë.

3. Një agjenci akreditimi, anëtare e ENQA-s ose e EQAR-it, gjatë vlerësimit të jashtëm të cilësisë mund të përdorë edhe ekspertë vlerësues vendas nga lista e miratuar e ekspertëve, sipas fushave të tyre të ekspertizës.

4. Raportet e vlerësimit të këtyre agjencive bëhen publike në faqen zyrtare të Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë.

5. Me kërkesë të vetë institucionit, ose të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, ose edhe të Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë, agjencitë e tjera mund të kryejnë veprimtari të udhëzimit, të trajnimit dhe të mbikëqyrjes së veprimtarive të vlerësimit të njësisë të sigurimit të brendshëm të cilësisë në një institucion të arsimit të lartë.

6. Veprimtaria e këtyre agjencive në territorin e Republikës së Shqipërisë mund të jetë e përkohshme ose e përhershme. Kur ato do të ushtrojnë një veprimtari të përhershme, duhet të fitojnë personalitetin juridik sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, për shoqëritë tregtare ose organizatat jofitimprurëse.

Neni 6

Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Akreditimit

1. Këshilli i Akreditimit funksionon pranë Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë. Ai organizohet sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Në këshill përfaqësohen në mënyrë të balancuar institucionet e arsimit të lartë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës, ekspertë të fushave, si dhe një student i propozuar nga Këshilli Kombëtar Studentor.

3. Ministri i Arsimit dhe Shkencës emëron anëtarët e Këshillit të Akreditimit nga kandidatët e propozuar nga palët e përfaqësuara. Numri i anëtarëve në Këshillin e Akreditimit i përcaktuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës është 9 anëtarë.

4. Këshilli i kryen veprimtaritë e tij në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me rregulloren e tij, e cila miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Mendimi i tyre duhet të jetë profesional, i paanshëm, transparent dhe koherent me vlerësimin e jashtëm.

5. Për çështje të cilat nuk mbulohen nga ekspertiza e anëtarëve të këshillit apo edhe kur gjykohet e nevojshme, ata mund të kërkojnë edhe ekspertë ose konsulentë të jashtëm që t'i asistojnë për formulimin e rekomandimeve sipas rastit të paraqitur.

6. Anëtarët e Këshillit të Akreditimit duhet të respektojnë edhe aktet ligjore dhe nënligjore që lidhen me konfliktin e interesave.

Neni 7

Detyrat e Këshillit të Akreditimit

Veprimtaritë kryesore të Këshillit të Akreditimit janë:

1. Miraton procedurat dhe metodologjinë e vlerësimit, si dhe dokumentet kryesore të përgjithshme dhe të veçanta për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin e programeve të studimit dhe të institucioneve të arsimit të lartë, të propozuara nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, mbështetur në aktet ligjore në fuqi, si dhe duke pasur në konsideratë udhëzimet dhe modelet europiane përkatëse.

2. Harton raportin e veprimtarive të kryera, në fund të çdo viti, në bashkëpunim me Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë, të cilën ia dërgon Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe e bën publik atë.

3. Shqyrton dhe miraton përbërjen e grupit të ekspertëve për çdo vlerësim të jashtëm, që propozohet nga agjencia, pas përzgjedhjes së tyre sipas fushave që do të vlerësojnë nga lista e përgjithshme e ekspertëve.

4. Shqyrton, mbështetur në legjislacionin në fuqi, vlerësimet e kryera nga APAAL dhe i rekomandon ministrit hapjen ose jo të programeve të reja të studimit, në institucionet publike të arsimit të lartë.

5. Shqyrton raportin përfundimtar të një vlerësimi të jashtëm dhe jep rekomandimet përkatëse për akreditimin, që i dërgohen Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

6. Shqyrton ankesat apo pretendimet për raportin e vlerësimit të jashtëm nga subjekti i interesuar. Këshilli vlerëson materialet e paraqitura, si edhe pretendimet e palës dhe vendos t'i marrë ato në konsideratë ose jo, ose vendos të dërgojë ndonjë grup tjetër vlerësuesish për vlerësim në institucion. Në të gjitha rastet, mendimet e ekspertëve/anëtarëve të këshillit shprehen në procesverbal dhe vendimi përfundimtar duhet të jetë i argumentuar. Vendimi të rekomandimit i bashkëngjitet edhe mendimi kundër. Në procesin e marrjes së vendimit, Këshilli i Akreditimit mund të kërkojë nga agjencia dhe institucioni që vlerësohet, informacione shtesë apo saktësime.

7. Në mbledhjet e Këshillit të Akreditimit merr pjesë, pa të drejtë vote, Drejtori i Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë. Një nga sektorët e Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë, është edhe në rolin e sekretarit të Këshillit të Akreditimit.

8. Formulon gjykimin e tij, mbështetur në rezultatet e vlerësimit të kryera nga agjenci të tjera sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje. Kjo e fundit, mund të thirret në mbledhje për të argumentuar mendimin e saj, duke treguar edhe standardet e përdorura për vlerësimin e jashtëm.

9. Përcakton parimet, kriteret dhe procedurat, mbështetur edhe nga agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe në bazë të rekomandimeve përkatëse europiane, për njohje reciproke të akreditimit, të fituar nga agjenci të tjera, si dhe për procedurat e akreditimit të programeve të përbashkëta ndërmjet dy a më shumë institucioneve shqiptare të arsimit të lartë, apo në bashkëpunim me një institucion të huaj të arsimit të lartë.

Neni 8

Veprimtari të tjera të Këshillit të Akreditimit

Këshilli i Akreditimit kryen dhe veprimtari të tjera, si:

1. Bashkëpunon me Këshillin e Arsimit të Lartë dhe Shkencës për të formuluar për Ministrin e Arsimit dhe Shkencës rekomandime për sigurimin e cilësisë në fushën e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor.

2. Bashkëpunon me Këshillin e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, për të formuluar kërkesat minimale cilësore dhe sasiore, lidhur me burimet njerëzore, të infrastrukturës dhe financiare, përshtatshmërinë e programeve të studimit dhe të kapaciteteve për kërkim, që nevojiten për hapjen e kategorive të ndryshme të institucioneve të reja të arsimit të lartë, njërive të reja kryesore e bazë të tyre, përfshirë dhe hapjen e filialeve, si dhe standardet e kërkuara për programet e studimit të tri cikleve.

Neni 9

Pagesa e anëtarëve të Këshillit të Akreditimit

Pagesa e kryetarit dhe e anëtarëve të Këshillit të Akreditimit të jetë 5000 lekë për çdo pjesëmarrje në mbledhje.

PJESA E DYTË VEPRIMTARITË DHE PROCESI I VLERËSIMIT

Neni 10

Veprimtaritë e vlerësimit

1. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë apo një agjenci tjetër akreditimi, kryen veprimtari lidhur me vlerësimin e jashtëm të cilësisë, efikasitetit dhe efikasitetit të veprimtarive institucionale të institucioneve të arsimit të lartë.

2. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë, si dhe programet e tyre i nënshtrohen procesit të vlerësimit paraprak, vlerësimit për akreditimin e parë dhe vlerësimit për akreditimin periodik.

3. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë në vlerësimin paraprak dhe atë për akreditimin, vlerëson aspektet institucionale dhe akademike të përshtatshme për qëllimin e vlerësimit. Aspektet e përgjithshme dhe të veçanta të vlerësimit, elementet përbërëse dhe kriteret e procedurat që ndiqen për vlerësimin institucional dhe/ose të programeve, përcaktohen me akte nënligjore të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

4. Gjatë procesit paraprak mbi bazë dokumentacioni dhe vlerësimin për akreditimin e parë, vlerësohen si aspektet institucionale, ashtu dhe ato të programeve që institucioni ofron. Në këtë proces vlerësohet gjithashtu shkalla e përputhjes ndërmjet objektivave, nivelit dhe kompetencave profesionale të synuara të programit të studimit dhe kurrikulës së ofruar, si dhe respektimin e rekomandimeve të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, për hartimin e planeve mësimore e programeve të disiplinave të ndryshme.

5. Në procesin e vlerësimit për akreditimin periodik, vlerësohen kryesisht aspektet institucionale dhe progresi i tyre në vijimësi nga akreditimi i mëparshëm, si dhe sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë së vetë institucionit. Në këtë fazë rishqyrtohen dhe përmbushja e rekomandimeve apo vërejtjeve të lëna nga akreditimi i mëparshëm.

6. Për garantimin e cilësisë në vijimësi, në periudhën midis dy akreditimeve, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë përcakton kriteret dhe parametrat për vlerësimin e vazhdueshëm të strukturave didaktike e kërkimore universitare, duke parashikuar për këtë edhe kontributin e vetëvlerësimit dhe verifikimet e kryera. Këto kritere janë të njëjta edhe për rastet e vlerësimeve në vijim të akreditimit me kusht, për fitimin e akreditimit pozitiv përfundimtar.

7. Në vlerësimin e jashtëm (të programeve të studimit, me synim akreditimin e tyre, përveç vlerësimit sipas pikës 2) agjencia vlerësuese përdor edhe kritere dhe indikatorë të tjerë vlerësimi, në përshtatshmëri edhe me fushën e veçantë disiplinore. Kriteret dhe indikatorët bëhen publikë para fillimit të procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë.

8. Në veprimtarinë e vlerësimit, agjencia duhet të përdorë analizat dhe krahasimin e indikatorëve cilësorë dhe sasiorë, të rezultateve të raportit të vlerësimit të jashtëm të ekspertëve, duke vlerësuar dhe duke u mbështetur gjithashtu edhe në raportin e vetëvlerësimit, kur ky i fundit është objektiv.

Neni 11

Procedura e vlerësimit

1. Institucionet e Arsimit të Lartë, të cilat kërkojnë t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit të jashtëm për akreditimin e parë, drejtojnë kërkesën e tyre për fillimin e këtij procesi, së paku 1 vit para përfundimit të studimeve në Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Këshillin e Akreditimit.

2. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, në bashkëpunim me Këshillin e Akreditimit, harton planin e akreditimit për institucionet e arsimit të lartë që kanë paraqitur kërkesën e tyre.

3. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, në bashkëpunim me Këshillin e Akreditimit, sipas planit të akreditimit të miratuar, fillon procesin e vlerësimit të jashtëm, jo më vonë se dy muaj nga data që institucioni ka dorëzuar raportin përfundimtar të vlerësimit të brendshëm të cilësisë.

4. Ministri i Arsimit dhe Shkencës mund t'i kërkojë Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Këshillit të Akreditimit përfshirjen në planin e vlerësimeve, edhe për institucione të reja të cilat janë në prag të dhënies së diplomave, por nuk kanë bërë kërkesë për fillimin e këtij procesi dhe për institucione të akredituara që nuk kanë bërë kërkesë e që kanë kaluar afatin kohor gjashtë vjet, të përcaktuar në ligj, për riakreditim.

5. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë ngre grupet e vlerësuesve sipas fushave dhe i miraton ato në Këshillin e Akreditimit.

6. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë mbikëqyr në tërësi procesin dhe siguron që ai të kryhet me korrektësi, në përputhje me procedurat e kriteret e vlerësimit, me objektivitet, transparencë dhe në barazi të plotë midis IAL-ve.

7. Agjencitë e tjera kryejnë këtë proces sipas parashikimeve në këtë rregullore, me vlerësuesit e tyre dhe sipas planifikimeve për të cilat ato bien dakord me institucionet e arsimit të lartë.

8. APAAL bën publike të gjitha raportet e vlerësimeve, aktet e Këshillit të Akreditimit dhe vendimin përfundimtar për akreditimet e kryera.

9. APAAL harton dokumente informuese për procesin e vlerësimit dhe ua bën të njohura ato institucioneve të arsimit të lartë.

Neni 12

Afatet kohore të vlerësimit dhe akreditimit

1. Vlerësimi institucional dhe i programeve të studimit zgjat jo më shumë se 6 muaj, në varësi nga konteksti i vlerësimit (paraprak mbi bazë dokumentacioni, për akreditimin e parë apo akreditimin periodik), objekti i vlerësimit (institucional, i programeve, apo vlerësim i kombinuar institucional/programor), si dhe nga numri i programeve në vlerësim dhe/ose madhësia e institucionit që vlerësohet.

Neni 13

Ekspertët e vlerësimit dhe konsulentët e jashtëm

1. Në ushtrimin e veprimtarisë së saj të vlerësimit, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Këshilli i Akreditimit aktivizojnë dhe bashkëpunojnë me ekspertë të jashtëm të vlerësimit dhe/apo konsulentë.

2. Ekspertët e vlerësimit duhet të kenë kualifikimet e duhura për llojin e vlerësimit që do të kryejnë, si dhe duhet të jenë të pavarur për të dhënë një gjykim të drejtë dhe pa ndikime, duke shmangur çdo konflikt të mundshëm interesi.

3. Çdo ekspert vlerësimi duhet të nënshkruajë një deklaratë, ku garanton për pavarësinë në veprimtarinë e tij dhe mungesën e konfliktit të interesit. Institucionit që vlerësohet duhet t'i jepet mundësia të komentojë në mënyrë të argumentuar mbi ekspertët e vlerësimit, para miratimit të tyre në Këshillin e Akreditimit.

4. Ekspertët e vlerësimit janë të detyruar të trajtojnë të gjitha materialet dhe rezultatet e vlerësimit si krejtësisht konfidenciale.

5. Mbështetur në dosjen e vetëvlerësimit dhe vizitat në vend, vlerësuesit përpilojnë raportin e vlerësimit të jashtëm të cilësisë, të cilin e dorëzojnë për procedura të mëtejshme në Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë. Anëtarë të grupeve të vlerësimit mund të jenë dhe ekspertë të huaj.

6. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Këshilli i Akreditimit mund të thërrasin edhe ekspertë konsulentë të jashtëm, për t'i ndihmuar me mendime dhe propozime për kriteret dhe metodat e vlerësimit, për rrugët dhe format e rritjes së cilësisë në arsimin e lartë, si dhe hartimin e dokumenteve që ndihmojnë procesin në tërësi.

7. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Këshilli i Akreditimit propozojnë të dhëna për zgjerimin dhe rifreskimin e bazës së të dhënave të ekspertëve të vlerësimit dhe të konsulentëve, vendas apo të huaj.

Neni 14

Tarifa e shërbimeve

1. Tarifat për shërbimet që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, nga ekspertët e jashtëm, vendas apo të huaj, dhe konsulentët, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrit të Financave.

2. Tarifat për shërbime nga agjenci të tjera, janë sipas përcaktimeve të bëra nga vetë ato agjenci dhe derdhen tërësisht në buxhetin e tyre.

3. Të ardhurat nga shërbimet e kryera nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë derdhen 90% në buxhetin e Agjencisë dhe 10% në Buxhetin e Shtetit. Mënyra dhe skema e përdorimit të këtyre të ardhurave përcaktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrit të Financave.

PJESA E TRETË AKREDITIMI, E DREJTA E ANKIMIT DHE PASOJAT JURIDIKE

Neni 15

Vendimi i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës

1. Ministri i Arsimit dhe Shkencës, pasi njihet me vlerësimet dhe rekomandimin e Këshillit të Akreditimit dhe pasi ka verifikuar nëse ka ankesa nga institucioni i interesuar, merr vendimin përfundimtar lidhur me akreditimin, i cili mund të jetë akreditim:

2. “pozitiv” ose “akreditohet”, kur përmbushen standardet dhe kriteret përkatëse institucionale apo të programeve.

3. “negativ” ose “nuk akreditohet” kur konstatohet një nivel i ulët i cilësisë dhe mosplotësimi i standardeve, si dhe pamundësi e institucionit për t’i përmbushur ato në një kohë të shkurtër.

4. Në ato raste kur gjykohet, dhe mbështetur në rezultatet e vlerësimit dhe rekomandimet e KA-së, Ministri i Arsimit dhe Shkencës vë kushte për akreditim duke përcaktuar afate që janë në përputhje me kapacitetet dhe mundësitë që ka institucioni, që brenda afatit të caktuar, të plotësojë kushtet e kërkuara.

5. APAAL, përmes një plani vazhdimësie, ndjek rast pas rasti plotësimin e kushteve që lihen, në përputhje me afatet përkatëse. Me plotësimin e kushteve brenda afateve të përcaktuara, Ministri i Arsimit dhe Shkencës jep akreditimin përfundimtar pozitiv. Në rast mosplotësimi, vendimi përfundimtar është negativ. Për rastet kur institucioni nuk i plotëson kushtet brenda afatit, por është në proces e sipër, ministri, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, mund të lërë edhe një afat të dytë për plotësimin e tyre.

6. Ministri i Arsimit dhe Shkencës duhet të shprehet, me vendim, lidhur me rekomandimet e Këshillit të Akreditimit, brenda një muaji nga marrja e dijeni e tyre, ose të rikthejë në Këshill raportin për rastet e parashikuara në këtë rregullore, brenda një muaji nga marrja e dijeni e tyre.

7. Vendimi i ministrit bëhet publik në faqen zyrtare të MASH-it dhe të Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë.

8. Kur Ministri i Arsimit dhe Shkencës nuk shprehet, Këshilli i Akreditimit e bën publik vendimin e tij, sipas përcaktimit në ligj.

Neni 16

Procedura e ankimit

1. Kur ka ankesa kundrejt procesit të vlerësimit, subjekti i interesuar, pasi ka konsumuar ankimin në Këshillin e Akreditimit apo në agjencinë vlerësuese, ka të drejtë t’i drejtohet Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

2. Ministri i Arsimit dhe Shkencës propozon ngritjen e një komisioni *ad-hoc* tripalësh, të përbërë nga përfaqësues të Këshillit të Akreditimit, agjencisë vlerësuese dhe të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

3. Vendimi i këtij komisioni i përcillet Këshillit të Akreditimit, i cili formulon mendimin përfundimtar pas ankimit dhe ia dërgon atë Ministrit të Arsimit dhe Shkencës në formë rekomandimi.

Neni 17
Pasojat e akreditimit negativ

1. Kur vendimi për akreditimin institucional dhe/ose të programit/eve të studimit i dhënë nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës është negativ, institucioni i nënshtrohet mbylljes së programit të studimit dhe nuk pranon studentë të rinj. Në rastet e mbylljes së IAL-së dhe/ose të programit/eve të studimit, ose rastet e pezullimit të veprimtarisë së tyre për një periudhë deri në dy vjet (mospranim të studentëve të rinj) apo heqjen e licencës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës i kërkon IAL-ve të veprojnë në përputhje me pikën 9 të nenit 44 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Ministria e Arsimit dhe Shkencës parashikon fonde shtesë për institucionin ose programin e studimit kur ai është publik, me qëllim riorganizimin e tij sipas cilësisë së kërkuar ose të vendosë ta mbyllë përfundimisht atë program studimi apo institucion.

VENDIM
Nr.426, datë 9.6.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË NDËRTIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË PORTIT TË JAHTEVE NË
KALANË E TURRËS, KOMUNA SYNEJ, KAVAJË, DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË “FINSEC
LTD”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pikat 1 e 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim, në pronësi të shtetit), të portit të jahteve në Kalanë e Turrës, komuna Synej, Kavajë, është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

2. Miratimin e bonusit prej 8.8 % të pikëve, për rezultatin teknik, financiar dhe mjedisor në procedurën përzgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Finsec ltd”.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.427, datë 9.6.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen–Kalimash.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet sipas listave bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen tokë arë 32 626 m², vlerësuar me çmimin 650 lekë/m², me vlerë 21 206 900 (njëzet e një milionë e dyqind e gjashtë mijë e nëntëqind) lekë, truall me sipërfaqe 7 368 m², vlerësuar me çmimin 1 500 lekë/m², me vlerë 11 052 000 (njëmbëdhjetë milionë e pesëdhjetë e dy mijë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 32 258 900 (tridhjetë e dy milionë e dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind) lekësh, si dhe për sipërfaqen tokë arë 34 499.9m², vlerësuar me çmimet sipas hartave të zonave të cilat preken, me vlerë 7 055 234.2 (shtatë milionë e pesëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e katër pikë dy) lekë, truall me sipërfaqe 853m², vlerësuar me çmimet sipas hartave të zonave të cilat preken, me vlerë 454 246 (katërqind e pesëdhjetë e katër mijë e dyqind e dyzet e gjashtë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 7 509 480.2, (shtatë milionë e pesëqind e nëntë mijë e katërqind e tetëdhjetë pikë dy) lekësh, objekte me vlerë 18 241 481 (tetëmbëdhjetë milionë e dyqind e dyzet e një mijë e katërqind e tetëdhjetë e një) lekë, me një vlerë totale shpronësimi prej 58 009 861.2 (pesëdhjetë e tetë milionë e nëntë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e një pikë dy) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 1 705 000 (një milion e shtatëqind e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera totale e shpronësimit prej 58 009 861.2 (pesëdhjetë e tetë milionë e nëntë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e një pikë dy) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 15.6.2010 dhe të përfundojë më 15.9.2010.

7. Pronarët e listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Pronarët e listave që i bashkëlidhen këtij projektvendimi, për të cilët është bërë shënimi “Proces legalizimi”, të likuidohen për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar ky proces dhe të jenë bërë regjistrimet përkatëse pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Mirditë.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi “Proces legalizimi”, sipas pikës 8 të këtij vendimi, dhe pasi të ketë marrë një konfirmim zyrtar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Mirditë.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA ZGJERIMI I SEGMENTIT
RRUGOR “RRËSHEN-REPS-THIRRË”

Nr.	Pronari			ZK	Nr. Pas.	Vlera Lekë	Fshati	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri					
1	Ndue	Frrok	Frroku	2162	107/9	1737422	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
2	Tonin	Fran	Frroku	3171	1/15	11143787	Reps	Konfirmuar nga ZRPP
3	Zef	Preng	Doda	3259	195	1986333	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
4	Shkurt	Preng	Ndoj	2610	137	1580992	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
5	Ndue	Preng	Ndoj	2610	145	1792947	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
TOTALI						18241481		

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR "RRËSHEN-REPS-THIRRË"

REFERUAR PUBLIKIMIT NË GAZETË NË PERIUdhËN NËNTOR - DHJETOR 2007

Nr	Pronari			ZK	Nr. Pas.	Tokë Arë			Tokë Truall			Vlera Totale lekë	Fshati	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip. m ²	Çmim l/m ²	Vlera lekë	Sip. m ²	Çmim l/m ²	Vlera lekë			
1	Gjergj	Llesh	Perleka	2769	18	186	650	120900				120900	Nderfushaz	Konfirmuar nga ZRPP
2	Fran	Frrok	Doda	2768	345/22	883	650	573950				573950	Nderfane	Konfirmuar nga ZRPP
3	Ilirjan	Dod	Doda	2768	345/24	123	650	79950				79950	Nderfane	Konfirmuar nga ZRPP
4	Mehill	Gjok	Bardhi	2768	315	200	650	130000				130000	Nderfane	Konfirmuar nga ZRPP
5	Tonin	Nikoll	Tuci	2768	314	327	650	212550				212550	Nderfane	Konfirmuar nga ZRPP
6	Mark	Ndue	Pjetri	2933	152/12	1650	650	1072500				1072500	Pshqesh	Konfirmuar nga ZRPP
7	Llesh	Gjon	Marku	2933	157/1	159	650	103350				103350	Pshqesh	Konfirmuar nga ZRPP
8	Nikoll	Mark	Gega	2933	176	500	650	325000				325000	Pshqesh	Konfirmuar nga ZRPP
9	Fran	Nikoll	Prendi	1221	91/2	695	650	451750				451750	Blinisht	Konfirmuar nga ZRPP
10	Nikolin	Pjeter	Prendi	1221	91/1	1743	650	1132950				1132950	Blinisht	Konfirmuar nga ZRPP
11	Gjet	Kol	Kolaj B/P	3171	3/11				500	1500	750000	750000	Reps	Konfirmuar nga ZRPP
12	Simon	Kol	Kolaj	3171	3/10				500	1500	750000	750000	Reps	Proces Legalizimi
13	Aleksander	Mark	Sinani	2610	187	450	650	292500				292500	Mashterkore	Konfirmuar nga ZRPP
14	Dod	Llesh	Ndreca	2610	165/1	96	650	62400				62400	Mashterkore	Konfirmuar nga ZRPP
15	Gjet	Ndue	Kaza	1893	362	539	650	350350				350350	Zajs	Konfirmuar nga ZRPP
16	Gjergj	Zef	Shyti	1893	366				198	1500	297000	297000	Zajs	Konfirmuar nga ZRPP
17	Gjon	Zef	Cera	3433	7/3	3077	650	2000050				2000050	Shtrungaj	Konfirmuar nga ZRPP
18	Mark	Preng	Gjoka	3433	51/2				300	1500	450000	450000	Shtrungaj	Proces Legalizimi
19	Illir	Mark	Gjoka	3433	51/3				500	1500	750000	750000	Shtrungaj	Proces Legalizimi
20	Mark	Preng	Gjoka	3433	51/4	1400	650	910000				910000	Shtrungaj	Konfirmuar nga ZRPP
21	Fran	Ndue	Cera	3433	8	1078	650	700700				700700	Shtrungaj	Konfirmuar nga ZRPP
22	Fran	Ndue	Cera	3433	9	1820	650	1183000				1183000	Shtrungaj	Konfirmuar nga ZRPP
23	Gjet	Nikoll	Pershqefa	1190	58/1	1586	650	1030900				1030900	Bisak	Konfirmuar nga ZRPP
24	Ndrec	Ndue	Gega	1190	131/2	600	650	390000				390000	Bisak	Konfirmuar nga ZRPP
25	Simon Lala, Ndue Shpani,			1190	131/1	600	650	390000				390000	Bisak	Konfirmuar nga ZRPP
26	Gjete	Kol	Marlekaj	1190	29/4	367	650	238550	500	1500	750000	988550	Bisak	Konfirmuar nga ZRPP
27	Leke	Gjok	Marlekaj	1190	29/5				134	1500	201000	201000	Bisak	Konfirmuar nga ZRPP
28	Ndrec	Gjok	Marlekaj	1190	29/6				139	1500	208500	208500	Bisak	Konfirmuar nga ZRPP
29	Ndrec	Ndue	Gega	1190	27/6				250	1500	375000	375000	Bisak	Konfirmuar nga ZRPP
30	Gjergj	Zef	Ndreca	2162	69/3				147	1500	220500	220500	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
31	Pjeter	Ndrec	Mhilli	2162	91/1	200	650	130000				130000	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
32	Gjet	Ndrec	Lleshi	2162	130/3	207	650	134550				134550	Klos	Konfirmuar nga ZRPP

33	Ndue	Pjeter	Marku	2162	99/4	292	650	189800				189800	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
34	Dod	Nikoll	Pershqefa	1600	2//3				300	1500	450000	450000	Fan	Konfirmuar nga ZRPP
35	Niko	Ded	Pershqefa	1600	2//2				200	1500	300000	300000	Fan	Konfirmuar nga ZRPP
36	Ferdinand	Ded	Deda	3883	197				300	1500	450000	450000	Zall-Xhuxh	Konfirmuar nga ZRPP
37	Ndoc	Ded	Deda	3883	44/4				300	1500	450000	450000	Zall-Xhuxh	Proces Legalizimi
38	Nikoll	Pjeter	Prenga	3883	68	865	650	562250				562250	Zall-Xhuxh	Konfirmuar nga ZRPP
39	Gazmend	Mark	Ndreca	3883	21/3				500	1500	750000	750000	Zall- Xhuxh	Proces Legalizimi
40	Rit	Mark	Ndreca	3883	21/5				500	1500	750000	750000	Zall- Xhuxh	Proces Legalizimi
41	Mark	Gjon	Ndreca	3883	21/6	550	650	357500				357500	Zall- Xhuxh	Konfirmuar nga ZRPP
42	Ndrec	Ndue	Ndreca	3883	21/8				500	1500	750000	750000	Zall- Xhuxh	Proces Legalizimi
43	Ndue	Preng	Nikolli	3883	17	2922	650	1899300				1899300	Zall- Xhuxhe	Konfirmuar nga ZRPP
44	Ndue	Preng	Nikolli	3883	187				300	1500	450000	450000	Zall- Xhuxhe	Proces Legalizimi
45	Llesh	Nikoll	Lleshi	3259	156	1100	650	715000				715000	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
46	Marte	Ndrec	Lleshi	3259	159	393	650	255450				255450	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
47	Nikoll	Ndue	Gjergji B/P	3259	75/1	6444	650	4188600				4188600	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
48	Gjin	Gjergj	Pjetri	3598	26/3	1574	650	1023100	500	1500	750000	1773100	Thirre	Proces Legalizimi
49	Nikoll	Llesh	Pjetri	3598	71/1				500	1500	750000	750000	Thirre	Proces Legalizimi
50	Nikoll	Gjon	Prenga	3598	244				300	1500	450000	450000	Thirre	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				32626		21206900	7368		11052000	32258900		

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA ZGJERIMI I SEGMENTIT RRUGOR "RRËSHEN-REPS-THIRRË"

Nr	Pronari			ZK	Nr. Pas.	Tokë Arë			Sip.m ²	Truall	Vlera lekë	Vlera Totale Lekë	Fshati	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip.m ²	Çmimi leke/m ²	Vlera lekë						
1	Nikoll	Mark	Gjoka	2769	267	4815	210	1011150				1011150	Nderfushaz	Konfirmuar nga ZRPP
2	Aleksander	Zef	Brunga	2769	73/4	12049	210	2530290				2530290	Nderfushaz	Konfirmuar nga ZRPP
3	Gjergj	Llesh	Perleka	2769	18	1462	210	307020				307020	Nderfushaz	Konfirmuar nga ZRPP
4	Bardhok	Gjon	Perleka	2769	19/3	732.3	210	153783				153783	Nderfushaz	Konfirmuar nga ZRPP
5	Nikoll	Pjeter	Perleka	2769	19/4	838	210	175980				175980	Nderfushaz	Konfirmuar nga ZRPP
6	Dava	Llesh	Perleka	2769	19/9	272	210	57120				57120	Nderfushaz	Konfirmuar nga ZRPP
7	Preng	Pjeter	Perleka	2769	19/10	245.2	210	51492				51492	Nderfushaz	Konfirmuar nga ZRPP
8	Gjok	Pjeter	Nikolli	2768	303/3	782.6	248	194084.8				194084.8	Nderfane	Konfirmuar nga ZRPP
9	Gjok	Pjeter	Nikolli	2768	302/1	450	248	111600				111600	Nderfane	Konfirmuar nga ZRPP
10	Dritan	Pjeter	Nikolli	2768	302/5	321	248	79608				79608	Nderfane	Konfirmuar nga ZRPP
11	Nikoll	Kol	Nikolli	2768	302/6	231	248	57288				57288	Nderfane	Konfirmuar nga ZRPP
12	Ded	Nikoll	Nikolli	2768	302/3	174	248	43152				43152	Nderfane	Konfirmuar nga ZRPP
13	Ndue	Nikoll	Prenga	2768	345/7	55	248	13640				13640	Nderfane	Konfirmuar nga ZRPP
14	Ndue	Nikoll	Prenga	2768	345/8	245.5	248	60884				60884	Nderfane	Konfirmuar nga ZRPP
15	Frrok	Ndue	Prenga	2768	345/10	690	248	171120				171120	Nderfane	Konfirmuar nga ZRPP
16	Ndue	Frrok	Prenga	2768	345/11	831.3	248	206162.4				206162.4	Nderfane	Konfirmuar nga ZRPP
17	Bardhe	Ndue	Prendi	1221	75/3	462	172	79464				79464	Blinisht	Konfirmuar nga ZRPP
18	Anton	Gjin	Prendi	1221	75/2	1198	172	206056				206056	Blinisht	Konfirmuar nga ZRPP
19	Shkurt	Preng	Ndoj	2610	101	146	186	27156				27156	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
20	Zef	Preng	Ndoj	2610	102	276	186	51336				51336	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
21	Ndue	Preng	Ndoj	2610	103	265	186	49290				49290	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
22	Aleksander	Mark	Sinani	2610	189	694	186	129084				129084	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
23	Aleksander	Mark	Sinani	2610	110	13	186	2418				2418	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
24	Gjovalin	Zef	Skana	2610	108	30	186	5580				5580	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
25	Zef	Llesh	Marku	2610	210	56	186	10416				10416	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
26	Ndue	Llesh	Marku	2610	212	41	186	7626				7626	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
27	Gjet	Llesh	Marku	2610	215	60	186	11160				11160	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
28	Gjovalin	Zef	Skana	2610	218	126	186	23436				23436	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
29	Zef	Bib	Tuci	2610	227				19	887	16853	16853	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
30	Ndue	Bib	Tuci	2610	231/1	354	186	65844				65844	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
31	Gjet	Preng	Marpepa	2610	238	23	186	4278				4278	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
32	Zek	Gjon	Marpepa	2610	240	201	186	37386				37386	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP

33	Preng	Gjon	Marpepa	2610	241	280	186	52080				52080	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
34	Gjet	Llesh	Prenga	2610	160/1	142	186	26412				26412	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
35	Zef	Gjon	Marpepa	2610	164	157	186	29202				29202	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
36	Zef	Bib	Tuci	2610	225	450	186	83700				83700	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
37	Ndue	Bib	Tuci	2610	228	475	186	88350				88350	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
38	Gjet	Llesh	Prenga	2610	133	198	186	36828				36828	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
39	Gjon	Llesh	Prenga	2610	134	22	186	4092				4092	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
40	Shkurt	Preng	Ndoj	2610	139				150	887	133050	133050	Mashterkor	Proces Legalizimi
41	Zef	Preng	Ndoj	2610	141				117	887	103779	103779	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
42	Ndue	Preng	Ndoj	2610	144	255	186	47430				47430	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
43	Frrok	Pal	Margjeci	2162	106	629	145	91205				91205	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
44	Ndue	Frrok	Marku (Frroku)	2162	104/1	250	145	36250				36250	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
45	Kujtim	Mark	Frroku	2162	104/2	300	145	43500				43500	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
46	Ndue	Frrok	Frroku	2162	103/1	200	145	29000				29000	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
47	Kujtim	Mark	Frroku	2162	103/2	100	145	14500				14500	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
48	Ndue	Frrok	Frroku	2162	105	1200	145	174000				174000	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
49	Kujtim	Mark	Frroku	2162	107/8				250	362	90500	90500	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
50	Ndue	Frrok	Marku (Frroku)	2162	107/9				250	362	90500	90500	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
51	Kujtim	Mark	Frroku	2162	107/10	30	145	4350				4350	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
52	Gjet	Preng	Frroku	2162	126/1	94	145	13630				13630	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
53	Ded	Nikoll	Prenga	3259	103/2	100	219	21900				21900	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
54	Pal	Preng	Prenga	3259	104/1	1101	219	241119				241119	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
55	Mark	Preng	Prenga	3259	106	378	219	82782				82782	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
56	Ndue	Preng	Prenga	3259	105				67	292	19564	19564	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				34499.9		7055234.2	853		454246	7509480.2		

VENDIM
Nr.429, datë 9.6.2010

**PËR SHPALLJEN E ZONËS ARKEOLOGJIKE “A” DHE “B” TË QYTETIT TË
SHKODRËS DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SË ADMINISTRIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 31, pika 1, e 53, pikat 1 e 2, të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave


VENDOSI:

1. Shpalljen e zonës arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Shkodrës, sipas hartës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Miratimin e rregullores së administrimit të zonës arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Shkodrës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Në pikën 1 të vendimit nr.6, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e zonave arkeologjike, brenda qendrave të banuara në Shkodër, Lezhë, Krujë, Durrës, Elbasan, Berat, Vlorë dhe Sarandë”, zonifikimi për qytetin e Shkodrës, shfuqizohet.
4. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe organet e njësisë së qeverisjes vendore, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Zona Arkeologjike "A" dhe "B" e qytetit te Shkodres



Vendim Nr _____, Date _____ 2010

MIRATOHET
KRYEMINISTRI
Prof. Dr. Sali BERISHA

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURES,
RINISE DHE SPORTEVE

MINISTRI
Ferdinand XHAFAJ

INSTITUTI I MONUMENTEVE TE
KULTURES "GANI STRAZIMIRI"

DREJTORI
Prof. Dr. Apollon BACE

AGJENCIA E SHERBIMIT
ARKEOLOGJIK

DREJTORI
Roland OLLI



RREGULLORE
PËR ADMINISTRIMIN E ZONËS ARKEOLOGJIKE “A” DHE “B” TË QYTETIT
TË SHKODRËS

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave për administrimin e zonës arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Shkodrës, mbështetur në ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar.

Neni 2

Ndërhyrjet në zonën arkeologjike “A” të qytetit të Shkodrës

1. Në zonën arkeologjike “A” të qytetit të Shkodrës lejohet:

a) Restaurimi dhe konservimi i monumenteve dhe strukturave arkeologjike, kryerja e sondazheve arkeologjike me synim studimin e plotë të zonës, mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

b) Rikonstrukcioni i rrugëve dhe të gjitha punimet në rrjetin inxhinierik-ujësjellës-kanalizimeve, ndriçim, telefoni, mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

c) Vendosja e konstruksioneve të lehta (dru, xham, plastikë, metal) me lartësi maksimale 3m, të cilat duhen realizuar larg mureve dhe strukturave të tjera të dallueshme apo të supozuara. Konstruksionet vendosen dhe përdoren nga institucionet shtetërore të specializuara, duhet të jenë të lëvizshme (të çmontueshme) dhe që në asnjë rast nuk dëmtojnë nëntokën dhe peizazhin, në funksion të ruajtjes, ekspozimit, informimit publik dhe nevojave të tjera që lidhen me veprimtarinë arkeologjike në veçanti dhe trashëgiminë kulturore në përgjithësi. Projekti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe për çdo rast duhet të përcaktojë saktësisht qëllimin, kohëzgjatjen, vendndodhjen e strukturës brenda zonës, si dhe planprojektin e saj.

Neni 3

Ndërhyrjet në zonën arkeologjike “B” të qytetit të Shkodrës

Në zonën arkeologjike “B” të qytetit të Shkodrës lejohen:

1. Ndërtimet e reja pas miratimit me shkrim nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë të kërkesave të subjekteve të interesuara.

2. Ndërtimet lejohen vetëm pas kryerjes paraprake nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik të vëzhgimit intensiv, sondazheve arkeologjike apo formave të tjera të testimit në varësi të potencialit që përfaqëson zona me miratim të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë.

3. Format e testimit përcaktohen nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, por kryesisht janë sondazhe që nuk cenojnë shtresat në rast të vijimit të gërmimit arkeologjik, studime gjeofizike, regjistrim dixhital i terrenit, vëzhgim intensiv arkeologjik etj.

4. Në rastet kur gjatë zbatimit të projektit ndërtimor zbulohen gjetje të rëndësishme të veçantë, projekti duhet të rishikohet. Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë miraton ndryshimet në projekt duke marrë në konsideratë konservimin, ruajtjen, si dhe bërjen e tyre të vizitueshme. Vetëm pas miratimit të ndryshimeve lejohet vazhdimi i punimeve.

Neni 4

Procedurat që ndiqen për ndërhyrjet ndërtimore në zonën arkeologjike “B”

1. Për çdo ndërhyrje në zonat arkeologjike “B”, subjekti ndërtues i interesuar vë në dijeni drejtorinë rajonale të kulturës kombëtare, Shkodër, zyrën e administrimit dhe koordinimit të parkut arkeologjik, Shkodër dhe paraqet pranë sekretarisë teknike të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë dokumentacionin si më poshtë:

- Fotokopje e noterizuar e lejes së sheshit të ndërtimit nga KRRT/KRRTRSH;
- Fotokopje e noterizuar e vendimit të gjykatës ose regjistrimit në QKR;
- Prokurë për personin e autorizuar për nënshkrimin e kontratës nëse nuk është administratori i subjektit.

2. Pas shqyrtimit dhe miratimit të kërkesës së subjektit nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik nënshkruan një kontratë me subjektin, për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve.

Neni 5

1. Për ndërhyrjet pa leje brenda zonës arkeologjike “B”, drejtoria rajonale të kulturës kombëtare, Shkodër pezullon menjëherë veprimtarinë e subjektit dhe njofton Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe strukturën përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Në rast se subjekti nuk pezullon veprimet brenda 24 orëve, drejtoria rajonale të kulturës kombëtare, Shkodër i drejtohet menjëherë inspektoratit ndërtimor urbanistik vendor dhe Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar për pezullimin e ndërtimit deri në prishjen e tij.

Neni 6

1. Në rast të shkeljeve të procedurave nga subjektet ndërtimore, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë për subjektin, si dhe për drejtuesin teknik përkatës, nuk merr në shqyrtim për një periudhë 3-vjeçare asnjë kërkesë për ndërtim në zona arkeologjike “B” në të gjithë territorin e vendit, apo në zona të tjera, ku sipas ligjit kërkohet miratimi i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë.

Neni 7

Gjetjet arkeologjike

1. Klasifikohen si vlera të rëndësishme objektet e luajtshme dhe të paluajtshme në kontekstet arkeologjike struktura murale (varre monumentale, pjesë mozaiku të shtrirë në një sipërfaqe mbi 4 m², afreske, ndërtime inxhinierike, pjesë arkitekturore që lidhen me strukturat murale dhe banesa, tempuj e godina të tjera shërbimesh).

2. Në rast gjetjesh të rëndësishme të paluajtshme, punimet e nisura pezullohen menjëherë nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik. Brenda afatit prej 10 ditësh nga ndërprerja e punimeve, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë vendos për veprimet e mëtejshme. Veprimet e mëtejshme në lidhje me vazhdimin e ndërtimit do të ndërmerren nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në cilësinë e sekretarisë teknike të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, jo më vonë se 30 ditë nga ndërprerja e punimeve. Nëse gjetjet janë me vlera të rëndësishme, punimet e filluara të ndërpriten përfundimisht. Vendimi në këtë rast merret nga organi që ka autorizuar fillimin e punimeve, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë.

3. Në rast se Agjencia e Shërbimit Arkeologjik i propozon ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore shpalljen monumet kulture të një objekti të paluajtshëm, Instituti i Monumenteve të Kulturës bën studimin e zonës mbrojtëse të saj brenda 30 ditëve nga zbardhja e vendimit për shpalljen monumet kulture.

4. Shpenzimet për kryerjen e hulumtimeve të nevojshme, përgatitjen e dokumentacionit, si dhe për ndryshimet e mundshme të projektit kur vendoset që gjetjet të mbrohen në vend (*in situ*), të gjitha shpenzimet për to, si dhe shpenzimet për kërkimet shkencore, veprimtaritë e nevojshme restauruese ose konservuese mbulohen 100% nga investitori.

5. Në rast të gjetjeve arkeologjike të rëndësishme, kur Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë vendos ndërprerjen përfundimtare të punimeve, investitori shpronësohet në bazë të kuadrit ligjor në fuqi.

Neni 8

Gërmimet e shpëtimit

1. Në rast gjetjesh arkeologjike të rëndësishme, zhvillohet gërmim i shpëtimit. Gërmimi i shpëtimit kryhet nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, në bashkëpunim me drejtorinë rajonale të Kulturës Kombëtare, Shkodër, zyrën e administrimit dhe koordinimit të parkut arkeologjik, Shkodër ose nga subjekte private me leje të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, nën mbikëqyrjen e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.

2. Në rast se gjatë kryerjes së gërmimit të shpëtimit gjykohet e nevojshme asistencë shkencore dhe teknike në terren e specialistëve të Institutit të Arkeologjisë, kërkohet zyrtarisht pjesëmarrja e tyre në gërmim.

3. Nëse pas kryerjes së gërmimit të shpëtimit zbulohen gjetje të rëndësishme të veçantë (strukturë, etj.), Agjencia e Shërbimit Arkeologjik pezullon gërmimin dhe propozon në Këshillin Kombëtar të Arkeologjisë ndryshimet në projekt, me synim mbrojtjen dhe bërjen të vizitueshme të këtyre vlerave.

4. Vazhdimi i punimeve ndërtimore lejohet mbas verifikimit nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik të përmbushjes së kriterëve të vendosura nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë për zbatimin korrekt të projektit të mbrojtjes dhe vizitueshmërisë.

5. Në përfundim të çdo gërmimi shpëtimi përgatitet një relacion i plotë, i cili i paraqitet Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë për miratim brenda 30 ditëve. Pas shqyrtimit dhe miratimit, një kopje e relacionit të plotë depozitohet edhe pranë Institutit të Arkeologjisë.

6. Në rastin kur gërmimi i shpëtimit kryhet nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, relacioni firmoset nga drejtuesi i grupit dhe nga anëtarët e tij, si dhe konfirmohet nga drejtori i Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.

7. Në rastin kur gërmimi i shpëtimit kryhet nga një subjekt privat, relacioni firmoset/konfirmohet nga drejtuesi i projektit të subjektit, minimumi 2 arkeologë të këtij subjekti dhe nga specialisti i autorizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, i cili ka qenë prezent gjatë gërmimit.

Neni 9

1. Vëzhgimi intensiv sipërfaqësor (survey) dhe sondazhet arkeologjike kryhen nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me drejtorinë rajonale të kulturës kombëtare, Shkodër dhe zyrën e administrimit dhe koordinimit të parkut arkeologjik, Shkodër. Në çdo projekt të ndërmarrë nga subjektet, është e detyrueshme pjesëmarrja e një përfaqësuesi të autorizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.

2. Kur subjekti privat kryen shkelje duke mos respektuar legjislacionin në fuqi, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik pezullon gërmimin dhe relaton menjëherë në Këshillin Kombëtar të Arkeologjisë, duke propozuar edhe masat përkatëse. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik vulos kantierin dhe e monitoron atë në bashkëpunim me drejtorinë rajonale të kulturës kombëtare, Shkodër dhe zyrën e administrimit dhe koordinimit të parkut arkeologjik, Shkodër.

3. Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë, pasi shqyrton rastin, vendos:

a) lënien në fuqi të vendimit të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik për pezullimin e punimeve;

b) shfuqizimin e vendimit për pezullim dhe lejimin e vijimit të punimeve.

4. Në rastet kur subjekti privat nuk e kryen gërmimin sipas kuadrit ligjor në fuqi, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë i delegon Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik të vazhdojë gërmimet.

5. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë është i formës së prerë.

Neni 10

Vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese

1. Në zonën arkeologjike “A” dhe “B” vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese për monumente të veçanta, rrënoja apo hapësira me potencial arkeologjik, bëhet vetëm

4444

në vendet e përcaktuara sipas rastit nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Agjencia e Shërbimeve Arkeologjike dhe zbatohet nga drejtoria rajonale e kulturës kombëtare, Shkodër dhe zyra e administrimit dhe koordinimit të parkut arkeologjik, Shkodër.

2. Në asnjë rast tabelat prezantuese dhe panelet shpjeguese nuk duhet të dëmtojnë apo konkurrojnë monumentin.

3. Vendosja e tabelave të sinjalistikës rrugore/turistike pranë monumenteve dhe zonave të mbrojtura rreth tyre bëhet në mbikëqyrjen e drejtorisë rajonale të kulturës kombëtare, Shkodër.

4. Për çdo veprimtari me karakter kulturor në zonat arkeologjike “A” dhe “B”, vendosja e tabelave dhe e materialeve publicitare lejohet në raste të veçanta festivo-kulturore dhe ka karakter të përkohshëm. Vendosja e tyre ekzekutohet vetëm në zbatim të urdhrit të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe nën mbikëqyrjen e drejtorisë rajonale të kulturës kombëtare, Shkodër dhe zyrës së administrimit dhe koordinimit të parkut arkeologjik, Shkodër.

5. Është e ndaluar vendosja e posterave publicitarë (jo kulturorë) dhe politikë, si dhe dëmtimet e tjera të monumenteve dhe rrënojave arkeologjike (vizatimi, shkrimi mbi strukturat e paluajtshme).

Neni 11

Kjo rregullore shoqërohet me hartën e zonifikimit, e cila rishikohet periodikisht bazuar në të dhënat e reja arkeologjike, si dhe nevojën për mbrojtjen e monumenteve.

Neni 12

Në studimet urbanistike për qytetin e Shkodrës duhet të merret parasysh zonifikimi arkeologjik i qytetit të Shkodrës dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje.

Studimet urbanistike të miratuara që janë në fazën e implementimit, si dhe rregulloret përkatëse të tyre duhet të rishikohen me qëllim që të zbatohet zonimi arkeologjik i qytetit të Shkodrës dhe përcaktimet e rregullores përkatëse.

VENDIM

Nr.430, datë 14.6.2010

PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË MICROSOFT CORPORATION, PËR PROJEKTIN E PARTNERITETIT STRATEGJIK, NË FUSHËN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 6 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve e marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Inovacionit dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “Microsoft Corporation”, për projektin e partneritetit strategjik, në fushën e teknologjisë së informacionit.

2. Ngarkohen Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Ministri i Financave dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

4445

VENDIM
Nr.432, datë 28.4.2010

PËR ZGJERIMIN E KUFIJVE TË REZERVATIT NATYROR TË MENAXHUAR KUNE-VAIN-TALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, 4/2, 9 dhe 13 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Zgjerimin e kufijve të rezervatit natyror të menaxhuar Kune-Vain-Tale, sipas hartës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kufijtë e këtij rezervati natyror të menaxhuar janë si më poshtë vijon:

a) Veri:

Pika 1, pranë bregut të detit, me koordinata 4383845.55V e 4630012.54L, vijon me rrugën automobilistike në drejtim të kënetës së Kënallës deri te pika 2, me koordinata 4385220.72V e 4630436.40L;

b) Lindje:

Pika 2 me koordinata 4385220.72V e 4630436.40L, më pas ndjek krahun e djathtë të rrugës Shëngjin-Lezhë deri te pika 3 me koordinata 4385879.67V e 4629324.62, vijon përgjatë kanalit kullues deri te pika 4 me koordinata 4385699.07V e 4629040.37L, ndjek kanalin në drejtim të hidrovorit deri te pika 5, me koordinata 4385939.31V e 4628779.49L, vijon me kanalin kullues deri te pika 6, me koordinata 4385514.65V e 4628343.99L, ndërpret rrugën që të çon te Stomi i Madh, vijon te pika 7, me koordinata 4385798.97V e 4627337.86L, vijon përgjatë kanalit kullues deri te pika 8, me koordinata 4385289.62V e 4627024.11L, dhe pika 9, me koordinata 4385657.92V e 4626310.00L, ndërpret lumin Drin, vijon me pikat: 10, me koordinata 4385550.50V e 4625947.52L, 11, me koordinata 4385644.16V e 4625692.46L dhe 12, me koordinata 4385187.59V e 4625643.98L, ndjek kanalin kullues në drejtim të jugut deri te pika 13, me koordinata 4385378.39V e 4623411.62L, dhe me pikën 14, me koordinata 4385440.83V e 4623428.55L, përsëri ndjek kanalin kullues deri te pika 15, me koordinata 4385720.35V e 4620888.01L, vijon përgjatë kanalit kullues në drejtim të jug-perëndimit deri te pika 16, me koordinata 4384493.60V e 4620398.30L, më pas në drejtim të pikave: 17, me koordinata 4384640.73V/4619439.95L, 18, me koordinata 4384325.88V e 4619383.86L, 19, me koordinata 4384482.24V e 4618768.96L, 20, me koordinata 4384282.75V e 4618729L dhe 21, me koordinata 4384430.12V e 4618172.86L, ndjek pjesërisht rrugën automobilistike Zejmen-Tale e Re, kalon te pika 22, me koordinata 4384742.49V e 4618226.38L, ndjek rrugën automobilistike nga Tale e Re në drejtim të lumit Mat deri te pika 23, me koordinata 4385012.32V e 4616775.39L;

c) Jug:

Pika 23, me koordinata 4385012.32V e 4616775.39L, dhe vijon përgjatë krahut të djathtë, në drejtim të rrjedhës së lumit Mat, deri te pika 24, me koordinata 4381044.13V e 4615097.81L, në grykëderdhjen e lumit Mat;

d) Perëndim:

Pika 24, me koordinata 4381044.13V e 4615097.81L, në grykëderdhjen e lumit Mat, dhe vijon përgjatë bregdetit Adriatik deri te pika 1, me koordinata 4383845.55V e 4630012.54L.

3. Rezervati natyror i menaxhuar Kune-Vain-Tale ka sipërfaqe të përgjithshme 4 393.21 (katër mijë e treqind e nëntëdhjetë e tre pikë njëzet e një) ha, ku pjesën kryesore të territorit e zënë sipërfaqet ligatinore, të ndjekura nga sipërfaqet bujqësore, pyjore dhe sipërfaqet me troje, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Rezervati natyror i menaxhuar Kune-Vain-Tale ndahet në nënzona ruajtjeje e administrimi, si më poshtë vijon:

a) Zona qendrore, me sipërfaqe 163.07 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre pikë zero shtatë) ha, e shënuar në hartë me 1a, 1b, përfshin habitatet kryesore pyjore, me bimësi ujore dhe dunat ranore të ishullit të Kunes, pjesë të lagunës së Merxhanit, Rivat e Drinit, pjesën e dunave ranore e pyjore të bregdetit, ndërmjet detit Adriatik dhe lagunës së Merxhanit. Ajo përcaktohet si zonë me vlera të larta për trashëgiminë natyrore e biodiversitetin dhe në të zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, që siguron një territor të pashqetësuar.

Në nënzonën 1b lejohen veprimtari dhe vizita turistike në natyrë, të cilat nuk bien ndesh me planin e menaxhimit.

b) Zonë rekreative, me sipërfaqe 501.04 (pesëqind e një pikë zero katër) ha, e shënuar në hartë me 2, përfshin habitatet kryesore pyjore, me bimësi ujore dhe dunat ranore të Kunes, pjesë të lagunës së Merxhanit, pjesën e dunave ranore dhe pyjore të bregdetit, ndërmjet lagunave të Zajës, Cekës dhe Gjolit të Buajve, pjesët pranë qendrës së vizitorëve Vain, të Togëzës dhe dunat e sipërfaqet ujore të Tales në grykëderdhjen e lumit Mat. Ajo përcaktohet si zonë me vlera për trashëgiminë natyrore, biodiversitetin, argëtimin, çlodhjen e turizmin mjedisor. Në të zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes, që siguron një territor me ndikim të ulët dhe kontroll të veprimtarive turistike, si mundësi shëtitjeje në natyrë, ndërtime turistike sipas vendimeve të KRRTRSH-së e lehtësi të tjera, në mënyrë të tillë që respekton funksionet e rezervatit natyror të menaxhuar, vlerat e tij ekologjike dhe ato të peizazhit natyror e kulturor.

c) Zona e përdorimit tradicional, me sipërfaqe 1 773.96 (një mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre pikë nëntëdhjetë e gjashtë) ha, e shënuar në hartë me 3, ku mundësohet vazhdimi vetëm i veprimtarive tradicionale, si bujqësi, peshkim dhe pyje, me përdorim të balancuar të tyre, pasi të pajisen me leje mjedisore, si dhe nuk lejohen ndërtimet e veprimtaritë që shkaktojnë ndryshimin e gjendjes natyrore të rezervave ujore, të burimeve, të lagunave dhe të sistemeve të zonave të lagura. Në këtë zonë përfshihen ishulli i Merxhanit, pjesët e lagunave të Merxhanit, Zajës, Cekës, Gjoli i Buajve, Zallit, Sakës, dunat ranore dhe sipërfaqet ujore të zonës ndërmjet bregdetit Tale 1 e 2 dhe të grykëderdhjes së lumit Mat. Në zonën e përdorimit tradicional zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes.

ç) Zona e përdorimit të qëndrueshëm, me sipërfaqe 4.54 (katër pikë pesëdhjetë e katër) ha, e shënuar në hartë me 4, ku përfshihet zona pranë grykës së lumit, të hidrovori i Tales. Në këtë zonë lejohen veprimtari të cilat nuk cenojnë integritetin ekologjik të ekosistemit dhe ushtrohen vetëm me leje mjedisore, që nuk bien ndesh me planin e menaxhimit. Në zonën e përdorimit të qëndrueshëm zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes.

d) Zona buferike, me sipërfaqe 1 950.60 (një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë pikë gjashtëdhjetë) ha, e shënuar në hartë me 5, ku mundësohet vazhdimi i veprimtarive ekonomike e sociale të qëndrueshme dhe përdorimi i balancuar i burimeve natyrore. Veprimtaritë e reja dhe infrastruktura mund të ushtrohen vetëm me leje mjedisore dhe sipas studimeve urbanistike të miratuara nga KRRTSH-ja, duke mos inkurajuar zhvillime ekonomike e sociale në tokat e lagëta me vlera për biodiversitetin. Në këtë zonë përfshihen pjesa bujqësore, ekonomike, urbane, kënetat e Kënallës, Ishull Shëngjini (Stomi i madh), Ishull Lezha, Lagjja e Pyllës, Barbulloja, Shënkolli, Gryka e Lumit, zonat Tale 1 e 2, tokat e lagëta dhe shtrati i vjetër i lumit Mat. Në zonën buferike zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes.

Për rastet e trashëgimisë kulturore, veprimtaritë mundësohen me leje të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në mbështetje të dispozitave të ligjit “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe ligjit “Për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike”.

5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në bashkëpunim me ministrinë e tjera të linjës, njësitë e qeverisjes vendore, institucionet kërkimore-shkencore, organizatat jofitimprurëse, përfaqësuesit e biznesit dhe pronarët privatë, merr masa për të siguruar zbatimin dhe monitorimin e planit të menaxhimit të parkut natyror.

6. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në bashkëpunim me ministrinë e tjera të linjës, njësitë e qeverisjes vendore, organizatat jofitimprurëse, përfaqësues të komunitetit të biznesit dhe pronarët privatë, ndjek zbatimin e studimit urbanistik për zhvillimin e turizmit dhe mbrojtjen e bregut të zonës së gjirit të Drinit dhe kontrollin e ndërtimeve, në zonën Kune-Vain-Tale, të cila gjenden brenda sipërfaqes së parkut natyror.

7. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, ministritë e tjera të linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore, të rishikojnë lejet që kanë dhënë për veprimtari ekonomike e shoqërore, për zonat Kune, Vain dhe Tale, të cilat gjenden brenda sipërfaqes së parkut natyror. Subjektet e pajisura me lejet përkatëse do të vazhdojnë të ushtrojnë këtë veprimtari, nëse nga pikëpamja ligjore, përmbushin kriteret e përcaktuara në ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, si dhe kur janë në përputhje me synimet dhe objektivat e planit të menaxhimit të parkut natyror.

8. Administrata ekzistuese e zonës së mbrojtur Kune-Vain kryen funksionet e administratës së rezervatit natyror të menaxhuar të Kune-Vain-Tale.

9. Ngarkohen, sipas përkatësisë, ministritë e linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela

SASIA E SIPËRFAQEVE, SIPAS PËRBËRJES

Nr.	Përdorimi i territorit	Sipërfaqja në ha
1	Sipërfaqe pyjore, shkurre, ripyllëzime, tokë me bimësi pyjore dhe ujore	1341.66
2	Sipërfaqe kullosore e livadhe	9.00
3	Sipërfaqe bujqësore (arë, pemëtore, vreshta)	1320.23
4	Sipërfaqe ujore (lumenj, ligatina, kanale kulluese e ujitëse)	1252.69
5	Sipërfaqe joproduhuese (ranore, rrugë e zhveshur)	79.78
6	Sipërfaqe urbane, zona ekonomike dhe troje të përziera me tokë bujqësore dhe pyjore	389.65
	Sipërfaqe e përgjithshme	4393.21



VENDIM
Nr.433, datë 5.5.2010

PËR KRIJIMIN, PËRBËRJEN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE KOMPETENCAT E BORDIT DREJTUES TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË STANDARDIZIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 10 të ligjit nr.9870, datë 4.2.2008 “Për standardizimin”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bordit drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (bordi i DSP-së), të përbërë nga 11 anëtarë, si më poshtë vijon:

- a) 2 (dy) përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
- b) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Punëve Publike, dhe Transportit;
- c) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- ç) 1 (një) përfaqësues nga universitetet;
- d) 1 (një) përfaqësues nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë;
- dh) 1 (një) përfaqësues nga Shoqata Konfindustria;
- e) 1 (një) përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit;
- ë) 1 (një) përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë;
- f) 1 (një) përfaqësues nga organizatat e mbrojtjes së konsumatorëve;
- g) 1 (një) përfaqësues nga Agjencia Rajonale e Zhvillimit të Biznesit, Tiranë.

1.1 Përfaqësuesit e ministrive janë në nivel drejtor të drejtorive që kanë lidhje në përdorimin e standardeve.

1.2 Përfaqësuesi i universiteteve është nga radhët e personelit të brendshëm akademik dhe duhet të gëzojë reputacion të lartë profesional e të ketë dhënë kontribut në hartimin e standardeve.

1.3 Përfaqësuesit e përmendur në shkronjat “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f” dhe “g”, të pikës 1 të këtij vendimi, të jenë persona në nivele të larta drejtuese, të cilët gëzojnë reputacion në fushat e tyre të biznesit dhe që kanë interes e përvojë në hartimin e zbatimit të standardeve.

1.4 Anëtarët e bordit drejtues qëndrojnë në detyrë për një mandat 2 (dy)-vjeçar, me të drejtë riemërimi edhe për një mandat të dytë.

1.5 Bordi drejtues ushtron veprimtarinë e tij në bazë të rregullores, miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë.

2. Misioni dhe qëllimi i bordit drejtues të DPS-së është sigurimi i përfaqësimit të palëve të interesuara në procesin e vendimmarrjes, i transparencës dhe i paanësisë në zhvillimin e veprimtarisë së standardizimit, në nivel kombëtar.

3. Kompetencat dhe mënyra e funksionimit të bordit drejtues

3.1 Bordi drejtues ka këto kompetenca:

- a) Miraton strategjinë e zhvillimit të DPS-së;
- b) Miraton programin vjetor të punës të DPS-së;
- c) Analizon dhe mbikëqyr përmbushjen e detyrave të DPS-së në zbatim të programit të punës;

ç) Miraton përbërjen, kompetencat dhe funksionimin e bordit teknik të DPS-së dhe kontrollon punën e tij;

d) Jep rekomandime, promovon, krijon dhe mbështet nismat për zhvillimin e veprimtarive të standardizimit, në nivel kombëtar e ndërkombëtar;

dh) Miraton marrëveshjet e bashkëpunimit që lidh DPS-ja;

e) Miraton aplikimin e DPS-së për anëtarësimin në organizmat europianë dhe ndërkombëtarë të standardeve.

3.2 Anëtarët e bordit drejtues të DPS-së qëndrojnë në detyrë deri në ditën e lirimit/shkarkimit të tyre.

Në rastet kur anëtari i bordit drejtues bëhet i paaftë fizikisht ose i hiqet zotësia për të vepruar, lirohet/shkarkohet nga detyra.

4. Zgjedhja dhe funksionet e kryetarit të bordit të DPS-së

4.1 Bordi i DPS-së, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh kryetarin.

4.2 Kryetari nuk mund të zgjidhet për më shumë se dy mandate dyvjeçare, radhazi.

4.3 Kryetari ushtron këto kompetenca:

a) Drejton mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të bordit;

b) Kontrollon zbatimin nga të gjithë anëtarët e bordit të detyrave të caktuara në mbledhjet paraardhëse.

4.4 Në mungesë të kryetarit, mbledhja drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë.

5. Pagesa e anëtarëve të bordit

5.1 Për çdo pjesëmarrje në mbledhje, kryetari dhe anëtarët e bordit drejtues shpërblehen në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, por jo më shumë se një herë në muaj.

5.2 Pagesat e anëtarëve/kryetarit të bordit mbulohen nga fondet buxhetore të DPS-së.

6. Mënyra e organizimit të mbledhjeve të bordit drejtues

6.1 Bordi mbledhet një herë në 6 (gjashtë) muaj. Mbledhjet janë të vlefshme kur janë të pranishëm të paktën 2/3 e anëtarëve. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash. Drejtori i Përgjithshëm dhe drejtorët e drejtorive të DPS-së marrin pjesë në mbledhjet e bordit pa të drejtë vote.

6.2 Për mbledhjet mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari i bordit, i cili nuk është anëtar bordi. Sekretari caktohet nga DPS-ja.

6.3 Mbledhjet lajmërohen nga sekretari i bordit, me një njoftim me shkrim, ku caktohen data, ora dhe rendi i ditës së mbledhjes. Ky njoftim i dërgohet secilit anëtar, të paktën 10 (dhjetë) ditë përpara zhvillimit të mbledhjes.

6.4 Mbledhjet e jashtëzakonshme thirren nga kryetari i bordit, pas këshillimit me drejtorin e përgjithshëm të DPS-së, kur gjykohet se nuk duhet pritur mbledhja e radhës për çështje të veçanta.

7. Marrja e vendimeve

7.1 Vendimet merren me votim të hapur, me shumicë absolute votash të pjesëmarrësve në votim. Votat numërohen nga sekretari i bordit dhe regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes.

7.2 Bordi i DPS-së zbaton procedurën e votimit të fshehtë, në rastet kur:

a) zgjidhet kryetari i bordit drejtues;

b) hidhet në votë lirimi/shkarkimi i një anëtar të bordit, para mbarimit të mandatit të tij dyvjeçar.

7.3 Vendimet e marra kanë efekt detyrues edhe për ata anëtarë të cilët nuk kanë qenë të pranishëm në votim.

8. Ngarkohen institucionet përgjegjëse, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, që brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të paraqesin kandidaturat përkatëse në DPS.

9. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.434, datë 26.5.2010

PËR KALIMIN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS, PËR FAKULTETIN E SHKENCAVE SOCIALE, TË OBJEKTIT NR.35, NË KOMANDËN E DOKTRINËS DHE STËRVITJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të nenit 901 e vijues të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përdorim, pa shpërblim, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për Fakultetin e Shkencave Sociale, të objektit nr.35, në Universitetin Ushtarak “Skënderbej”, pjesë e pronës nr.12 “Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes”, pronë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, me qëllim zhvillimin e programit mësimor për periudhën 12.10.2009-30.9.2010.

2. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Fakultetit të Shkencave Sociale u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojnë atë ose ta japin në përdorim të tretët.

3. Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës të lidhin kontratën e huapërdorjes, duke përcaktuar detyrimet për secilin institucion.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.435, datë 2.6.2010

PËR ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE QË KRIJOHEN NGA SHITJA E DOKUMENTACIONIT TATIMOR, PULLAVE FISKALE DHE BILETAVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 52 të ligjit nr.9920, datë 15.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjës “c” të nenit 46 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Të gjitha të ardhurat e realizuara nga shitja e dokumentacionit tatimor, pullave fiskale dhe biletave të transportit rrugor të përdoren nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për përballimin e shpenzimeve të prodhimit dhe shpërndarjes së tyre, sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e Ministrit të Financave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.436, datë 2.6.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1634, DATË 17.12.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE TË MËNYRËS SË
MBËSHTETJES FINANCIARE, PËR RUAJTJEN E REZERVËS GJENETIKE TË RACËS
AUTOKTONE TË BUAJVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 3 e 4 të nenit 58 të ligjit nr.9426, datë 6.10.2005 “Për mbarështimin e blegtorisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1634, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Shkronjat “b” e “c” të pikës 1, në tabelën e pagesave, ndryshohen, si më poshtë vijon:

Numërtimi, emërtimi	për ruajtje	për pjellje	për remont
---------------------	-------------	-------------	------------

“b. Për buajt (M)	30 000 lekë;		
-------------------	--------------	--	--

c. për remontin			20 000 lekë.”.
-----------------	--	--	----------------

2. Në pikën 3 bëhen këto ndryshime:

- Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b. Pagesa për ruajtjen e buallit të jepet në fund të 6-mujorit të parë të vitit kalendarik, pas verifikimit të tij si ndërzyes në librin e ndërzim-pjelljeve të fermës së buajve.”.

- Shkronja “ç” shfuqizohet.

- Shkronja “d” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“d. Pagesa për remontin fermer jepet vetëm për mushkoret e moshës 16-18 muaj në fermat që mbarështojnë 10-30 krerë buallica.”.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

4. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.437, datë 9.6.2010

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E
NJERIUT, DATË 8.12.2009, PËR ÇËSHTJEN NR.44023/01 “CAKA KUNDËR
SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventas Europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 8.12.2009 për çështjen nr.44023/01 “Caka kundër Shqipërisë”, në shumën 3 000 (tre mijë) euro, si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin, në masën 10 për qind të kësaj shume.

2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave dhe afati, brenda të cilit duhet kryer ky ekzekutim, është data 16.6.2010.

3. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

4. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në njërën nga bankat e niveli të dytë, në emër të ankuesit, shtetasit Lulëzim Caka, dhe të konvertohet në lekë me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

5. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 4 të këtij vendimi, në favor të ankuesit, shtetasit Lulëzim Caka, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM Nr.438, datë 9.6.2010

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 467, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR KUALIFIKIMIN, SHKENCOR E PEDAGOGJIK, TË PERSONELIT AKADEMIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.467, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

a) Në fund të pikës 2.2.1 “Kriteret për dhënien e titullit “Prof. Asoc.””, shtohet paragrafi i mëposhtëm:

“Për personelin akademik të Akademisë së Arteve, krijues apo interpretues aktivë (kompozitorë, instrumentistë, këngëtarë, dirigjentë, aktorë, regjisorë, krijues të arteve pamore, skenografë, koreografë, balerinë), për marrjen e titullit “Prof. Asoc.”, kriteri për gradën shkencore “Doktor”, përmendur në këtë pikë, nuk përbën detyrim.”.

b) Në fund të pikës 2.3.1 “Kriteret për dhënien e titullit “Profesor””, shtohet paragrafi i mëposhtëm:

“Për personelin akademik të Akademisë së Arteve, krijues apo interpretues aktivë (kompozitorë, instrumentistë, këngëtarë, dirigjentë, aktorë, regjisorë, krijues të arteve pamore, skenografë, koreografë, balerinë), për marrjen e titullit “Prof.”, kriteri për gradën shkencore “Doktor”, përmendur në këtë pikë, nuk përbën detyrim.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Akademia e Arteve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.439, datë 9.6.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1070, DATË 21.10.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT DHE TË TARIFAVE TË SHKOLLIMIT NË PROGRAMET E STUDIMEVE “MASTER I NIVELIT TË DYTË”, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2009 – 2010, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.829, DATË 29.7.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE “MASTER I NIVELIT TË DYTË”, NË FAKULTETIN E MUZIKËS, TË AKADEMISË SË ARTEVE, DHE MIRATIMIN E KUOTAVE DHE TË TARIFAVE PËR KËTO PROGRAME””, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34 dhe 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1070, datë 21.10.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1:
 - a) në paragrafin e parë, shifra “ ... 1615 ...” bëhet “...1625...”;
 - b) në shkronjën “a”, shifra “ ... 1565 ...” bëhet “...1575...”.
 2. Në shkronjën “c” “Sistemet e transportit dhe menaxhimi i trafikut”, të numrit rendor 2, në tabelën B “Universiteti Politeknik i Tiranës”, pjesë e tabelës 1, që i bashkëlidhet vendimit, kuota 20 ndryshohet dhe bëhet 30.
 3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.440, datë 9.6.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, PRANË KOLEGJIT PROFESIONAL PRIVAT “NEW GENERATION” (BREZI I RI), TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 26, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- 1.Hapjen, në kolegjin profesional privat “New Generation” (Brezi i Ri), Tiranë, të programeve të studimit jouniversitare, në formën e studimeve me kohë të plotë, në:
 - a) Parukeri të avancuar;
 - b) Estetikë të avancuar.
2. Këto programe studimi jouniversitare, realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 (dy) vite akademike. Në përfundim të programeve të studimit lëshohet diplomë në:
 - a) Parukeri të avancuar;

b) Estetikë të avancuar.

3. Kolegji profesional privat “New Generation” (Brezi i Ri), Tiranë, ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, vetëm pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

4. Ky institucion duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.441, datë 9.6.2010

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 730, DATË. 6.11.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË PUNËS DHE PËR
CAKTIMIN E PËRFAQËSUESVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NË KËTË
KËSHILL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 6, 9 e 10 të nenit 200 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 17 të vendimit nr.730, datë 6.11.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “dh”, me këtë përmbytje:

“dh) zhvillimin e seminareve dhe të workshop-eve kualifikuese tripalëshe.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.442, datë 16.6.2010

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.718, DATË 29.10.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në fund të shkronjës “A”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”, shtohen personat e renditur në listën “a”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talebanët”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për talibanët dhe Al-Qaida-n.

2. Në fund të shkronjës “C”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, shtohen personat e renditur në listën “b”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat dhe kompanitë që kanë lidhje me talibanët dhe Al-Qaida-n, si dhe personat, organizatat dhe kompanitë, të cilat rezultojnë si financuese apo që ndihmojnë terroristët dhe organizatat terroriste.

3. Në fund të shkronjës “D”, “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, shtohen kompanitë e renditura në listën “c”, “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat dhe kompanitë që kanë lidhje me talebanët dhe Al-Qaida-n, si dhe personat, organizatat dhe kompanitë, të cilat rezultojnë si financuese apo që ndihmojnë terroristët dhe organizatat terroriste.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

A) LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME TALEBANËT:

1. SIRAJUDDIN JALLALOU DINE HAQQANI

B) LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA:

1. ADIL MUHAMMAD MAHMUD ABD AL-KHALIQ,
2. ABU SUFIAN AL-SALAMABI MUHAMMED AHMED ABD AL-RAZZIQ,
3. GHUMA ABD'RABBAH,
4. ABDULBASIT ABDULRAHIM,
5. NAJMUDDIN FARAJ AHMAD,
6. JABER ABDALLAH JABER AHMAD AL-JALAHMAH,
7. HAMID ABDALLAH AHMAD AL-ALI,
8. ABD AL-RAHMAN AL-FAQIH,
9. MOHAMMED AL GHABRA,
10. ABD AL-RAHMAN MUHAMMAD JAFFAR 'ALI,
11. FAHID MUHAMMAD 'ABD AL-'AZIZ AL-KHASHIBAN,
12. ABD AL HAMID SULAIMAN MUHAMMED AL-MUJIL,
13. FAZËL-A-TUL SHAYKH ABU MOHAMMED AMËN AL-PESHAWARI,
14. SAID ALI AL-SHIHRI,
15. KHALIFA MUHAMMAD TURKI AL-SUBAIY,
16. ABDUL RAHIM AL-TALHI,
17. NASIR 'ABD-AL-KARIM 'ABDULLAH AL-WAHISHI,
18. MUHSIN 2: FADHIL AYED ASHOUR AL-FADHLI,
19. HAJI MUHAMMAD ASHRAF,
20. RICARDO PEREZ AYERAS,
21. MAHMOUD MUHAMMAD AHMED BAHAZIQ,
22. MOHAMMED BENHAMMEDI,
23. IBRAHIM ABDUL SALAM MOHAMED BOYASSWR,
24. SUHAYL FATILLOEVICH BURANOV,
25. SULAYMAN KHALID DARWISH,
26. AHMED DEGHDEGH,

27. REDENDO CAIN DELLOSA,
28. FELICIANO SEMBORIO DELOS REYES JR,
29. PIO ABOGNE DE VERA,
30. YAHIA DJOUADI,
31. ABDELMALEK DROUKDEL,
32. REDOUANE EL HABHAB,
33. MAFTAH MOHAMED ELMABRUK,
34. ABDELRAZAG ELSHARIF ELOSTA,
35. SALAH GASMI,
36. FRITZ MARTIN GELOWICZ,
37. GUN GUN RUSMAN GUNAWAN,
38. ABID HAMMADOU,
39. ABDUL HAQ,
40. BEKKAY HARRACH,
41. JAMAL HOSNI,
42. AL SAYYID AHMED FATHI HUSSEIN ELIWAH,
43. NAJMIDDIN KAMOLITDINOVICH JALOLOV,
44. ABDULBAQI MOHAMMED KHALED,
45. ZAKI-UR-REHMAN LAKHVI,
46. RUBEN PESTANO LAVILLA, JR,
47. MOHAMED MOUMOU,
48. MUBARAK MUSHAKHAS SANAD MUBARAK AL-BATHALI,
49. MOHAMMED YAHYA MUJAHID,
50. TAHIR NASUF,
51. DINNO AMOR ROSALEJOS PAREJA,
52. JOKO PITONO,
53. ARIF QASMANI,
54. ABU RUSDAN,
55. HAFIZ MUHAMMAD SAWD,
56. HILARION DEL ROSARIO SANTOS III,
57. DANIEL MARTIN SCHNEIDER,
58. ATILLA SELEK,
59. MUHAMMAD 'ABDALLAH SALIH SUGHAYR,
60. ANGELO RAMIREZ TRINIDAD,
61. ADEM YILMAZ,
62. ZULKARNAEN.

C) LISTA E KOMPANIVE QË I TAKOJNË OSE BASHKËPUNOJNË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA:

1. AL-QAIDA IN IRAQ
2. AL-QAIDA IN THE ARABIAN PENINSULA (AQAP)
3. ISLAMIC JIHAD GROUP
4. MEADOWBROOK INVESTMENTS LIMITED
5. MOVEMENT FOR REFORM IN ARABIA
6. OZLAM PROPERTIES LIMITED
7. RAJAH SOLAIMAN MOVEMENT
8. SANABEL RELIEF AGENCY LIMITED
9. SARA PROPERTIES LIMITED

VENDIM
Nr.444, datë 9.6.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.289, DATË 28.4.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPALLJEN “PARK KOMBËTAR” TË EKOSISTEMIT NATYROR
DETAR PRANË GADISHULLIT TË KARABURUNIT DHE ISHULLIT TË SAZANIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 1, shkronja “b”, 6 e 13 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.289, datë 28.4.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2 fjalët “...12 570.82 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë pikë tetëdhjetë e dy) ha...” zëvendësohen me “...12 427.95 (dymbëdhjetë mijë e katërqind e njëzet e shtatë pikë nëntëdhjetë e pesë) ha...”.

2. Në pikën 2.1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në paragrafin e parë fjalët “...9 848.95 (nëntë mijë e tetëqind e dyzet e tetë pikë nëntëdhjetë e pesë) ha...” zëvendësohen me “...9 706.08 (nëntë mijë e shtatëqind e gjashtë pikë zero tetë) ha...”.


b) Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a. Veri: Pika 1 (në det), me largësi 1 milje detare (1 852m) nga Kepi i Gjuhëzës, me koordinata 4353018.48V e 4478005.72L, deri te pika “a”, me koordinata 4354828.86V/4480135.43L, më pas vijon në mënyrë drejtvizore me pikën “b”, me koordinata 4358373.04 V/4481423.68 L, vijon deri te pika 2 (në det), me largësi 1 milje detare (1 852 m) nga Kepi i Shën Vasilit, me koordinata 4363780.19V e 4477378.71L.”.

3. Harta që përmendet në pikën 1, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me hartën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 9.7.2010
Doli nga shtypi më 12.7.2010

Tirazhi: 2300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë